

Tartabiqet

Tartabiqet (*Cimex lectularius*) janë përhapur me shpejtësi nëpër botë. Ato përhapen kryesisht përmes valixheve të udhëtimit ose krevateve apo mobilieve ku janë grumbulluar. Gjatë natës ato thithin gjakun e njerëzve dhe të kafshëve. Gjatë ditës fshihen në afërsi të krevatit në plasaritjet e errëta të mobilieve ose në skarën e krevatit, poshtë ose mbi dyshek. Tartabiqet nuk kanë lidhje me kushtet higjienike; kushdo mund të preket. Në rast infestimi, kjo mund të zgjidhet vetëm me anë të një kontrolli profesional të insekteve.

Pamja

- Kur rriten plotësisht janë rreth 4 - 6 mm të gjata dhe të sheshta, kur njomen pothuajse 10 mm të gjata, si dhe me ngjyrë kafe të kuqërremtë.
- Tartabiqet e reja janë më të vogla dhe me ngjyrë më të çelët.




Tartabiqet e rritura tekta ushqehen me gjak. Foto: Qyteti i Zyrihut, UGZ

Rëndësia dhe mënyra e jetesës

- Thith gjakun e njerëzve dhe kafshëve shtëpiake, veçanërisht gjatë natës.
- Gjatë ditës fshihet në plasaritjet e krevatit, mobilie dhe në dhomë.
- Mund të zhvendoset nga një shtëpi në tjetrën, p.sh. nëse përpigëni ta luftoni me insekticid.
- Femrat bëjnë deri në 500 vezë.
- I rezistojnë të ftohtit për periudha të gjata dhe gjendjes së urisë deri në 6 muaj.
- Jetojnë rreth 1 vit.

Dëmet

- Gjatë natës pickojnë pjesët e zbuluara (qafën, fytyrën, krahët, kyçet e këmbëve etj.).
- Reaksionet ndaj pickimeve shpesh ndodhin disa orë ose ditë pas pickimit.
- Rreth 20% e popullsisë nuk shfaq asnjë reaksion në lëkurë nga pickimet e tartabiqeve.
- Transmetimi i sëmundjeve nga tartabiqet nuk njihet akoma deri më sot.



Cikli jetësor i tartabiqeve. Figura: Zhvillimi i tartabiqes

Luftimi

- Luftojini vetëm kur gjeni vërtet tartabiqe.
- **Mos u përpiqni t'i luftoni vetë tartabiqet me insekticide, pasi kjo do t'i trembë dhe do të shpërndahen në të gjithë apartamentin apo shtëpinë.**
- Kjo duhet të bëhet vetëm nga një kompani e specializuar për luftimin e insekteve, me licencë federale.
- Qëllimi duhet të jetë shfarosja totale.
- Në shumicën e rasteve duhet më shumë se një trajtim me insekticid. Alternativat: Trajtim me të ngrohtë, të ftohtë, pluhur silikat, avull.
- **Trajtimi nuk mbron nga rishfaqja e tyre.**

Parandalimi

- Krevetat dhe mobiliet e përdorura, kontrollojini për tartabiqe, shenja feçesh ose gjurmë gjaku.
- Kutitë e kartonit të përdorura mund të jenë gjithashtu plot tartabiqe.
- Rrobat e përdorura lajini me 60 °C ose thajini në tharëse me 45 °C.
- Në rast se keni tartabiqe, mos lini mobilie në shkallë, bodrum ose papafingo, në mënyrë që të mos përhapen edhe te komshinjët.
- Kur hidhni mobilie, shënojinë në mënyrë të qartë nëse **janë pushtuar nga tartabiqet** ose bëjini të papërdorshme, në mënyrë që njerëzit e tjerë të mos i marrin me vete në shtëpi ato mobilie dhe tartabiqet.
- **Kur flini tek të afërm ose të njohur, bëni kujdes mos ju ngjiten tartabiqe në çantë apo valixhe.**
- Kur shkoni në një hotel ose shtëpi pushimi, përdorni një ndriçues të fuqishëm për të kontrolluar kornizat dhe skarën e krevatit nëse kanë tartabiqe të gjalla ose gjurmë feçeje (shihni figurën në kolonën tjetër).

Si të kuptoni nëse jeni infestuar nga tartabiqet?

- Gjatë ditës, fshihen në skeletin e krevatit dhe plasaritjet pranë krevatit.
- Gjurmë feçesh, pika të vogla të zeza (shihni figurën në kolonën tjetër) ose gjurmë gjaku mbi çarçafë.
- Kontrolli i banesës me ndihmën e një qeni që nuhat praninë e tartabiqeve do të sillt trajtime më efikase dhe më ekonomike.

Çfarë të bëni nëse në dhomën e hotelit ka tartabiqe?

- Informoni menaxherin e hotelit.
- Kërkoni një dhomë tjetër, mundësisht jo shumë afër dhomës që po lini.
- Vendosini valixhen mundësisht sa më larg krevatit dhe mbyllni gjithë zinxhirët.



Feçe tartabiqesh në skeletin e krevatit në rast infestimi të rëndë të krevatit. Foto: Qyteti i Zyrihut, UGZ

Çfarë të bëni pasi keni kaluar natën në një dhomë të infestuar nga tartabiqet?

- Shpaketojeni valixhen në ballkon.
- Nëse nuk mund t'i lani rrobat menjëherë, vendosini në qeska rrobash të mbyllura mirë hermetikisht.
- Lajini menjëherë rrobat me 60 °C për 30 minuta ose dy herë njëra pas tjetrës me 40 °C.
- Në tharësen e rrobave me 45 °C për 30 minuta
- Në frigorifer me -17 °C për më shumë ditë.
- Valixhet/çantat bosh spërkatinë jashtë shtëpisë me insekticid nga brenda dhe nga jashtë. Së fundi, ajrosni mirë bodrumin ose ballkonin.

Baza ligjore

Kushdo që porositi një shërbim në një kompani, duhet të mbartë edhe kostot. Pronarët e shtëpisë ose menaxheri duhet ta japin ambientin me qira në gjendje të mirë, pa parazitë (shihni OR, veçanërisht sipas ligjit të qiradhënies dhe "Dekretin kantonial për higjienën e përgjithshme dhe rezidenciale". Nëse ka parazitë në momentin që një qiramarrës hyn në banesë, konsiderohet si problem në pronën e dhënë me qira. Pronari është përgjegjës për zgjidhjen e këtij problemi. Kostot nuk mund t'i kalohen thjesht qiramarrësit. Në Kodin e Detyrimeve neni. 256, 257f, g, h, 258 dhe 259, rregullohet baza ligjore në objektet e banimit.

Ne mund t'ju ndihmojmë më tej

Na telefononi, na i dërgoni ose na i sillni insektet për identifikim. Shërbimi ynë i këshillimit është falas dhe vetëm për banorët e qytetit të Zyrihut. Oraret e telefonatave, nga e hëna në të premte, ora 13:30 deri 14:30.

Qyteti i Zyrihut
Mbrojtja e mjedisit dhe e shëndetit
Qendra për parandalimin e parazitëve
Eggbühlstrasse 23
8050 Zyrihut
T +41 44 412 28 38

Stadt Zürich
Umwelt- und Gesundheitsschutz
Fachstelle Schädlingsprävention
Eggbühlstrasse 23
8050 Zürich
T +41 44 412 28 38
ugz-schaedlingspraevention@zuerich.ch
stadt-zuerich.ch/schaedlingspraevention